



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:211152

Datë: 22.10.2020

Numri i dokumentit: 01232955

P.nr.1012/19

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me asistimin e bashkëpunëtorit profesional Driton Ahmeti në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen penale kundër të akuzuarve: Rr.B. nga fshati Komuna Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-ës dhe Y.B. për shkak se ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP.nr.1383-13/19 e datës 23 Shtator 2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor publik, në prezencën e prokurorit të shtetit Zana Sadiku Sertolli, përfaqësuesit juridik të DBPZHR-së Liridon Jetishi si dhe të akuzuarve me datë 24 Shtator 2020 morri dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 22 Tetor 2020, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I.Rr.B. i lindur me datë, nga i ati e ëma, jeton në Komuna Ferizaj, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i dy fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion bujk, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

II.Y.B. i lindur me datë, nga i ati e ëma e gjinsë, jeton ne fshatin Komuna Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion shofer, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

JANË FAJTOR

I.I akuzuari Rr.B.:

Sepse me datë 04 Korrik 2019, rreth orës 12:00, në pyllin publik në Rajonin Ekonomiko-Pyjor Nerodime – Jezerc Komuna Ferizaj, në vendin e quajtur Reka e Madhe, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetes ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme ka prerë trungje në pyll, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.2003/3 për pyjet e Kosovës, në atë mënyrë që duke përdor sharrë motorike ka prerë drunjë të llojit Ahu, me vëllim të përgjithshëm rreth 4.00 m3.

- **me të cilin veprim ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-ës.**

-

II. I akuzuari Y.B.:

Sepse me datë 04 Korrik 2020, rreth orës 18:30, në fshatin Jezerc Komuna Ferizaj, në vendin e quajtur “Te Balitet”, me dashje i ka ndihmuar të akuzuarit Rr.B.t, për të kryer veprën e lartë cekur, në atë mënyrë që kishte vënë në dispozicion mjetin transportues, përkatësisht kamionetën e tij të markës Iveco, ngjyrë e verdhë, me targa të regjistrimit 05-988-DM me numër të shasisë ZOFC355010D030669, për të transportuar drunjët e prerë ilegalisht.

- **Me të cilin veprim ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-ës.**

-

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2, 4, 7, 8, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPP-ës, i,

G J Y K O N

I.Të akuzuarin Rr.B.

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 1(një) viti, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

II.Të akuzuarin Y.B.

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 1(një) viti, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen veprën tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

Në bazë të nenit 284 par. 1 të KPP-ës, refuzohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj lidhur me konfiskimin e konfiskimin e mjetit transportues-kamionetën e firmës Iveco, ngjyrë e verdhë, me targa të regjistrimit , me numër të shasisë ZOFC355010d030669, pronë e të akuzuarit Y.B..

Pala e dëmtuar Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhivillim Rural nga Ferizaj, me përfaqësues juridik për realizimin e kërkesës pasuore – juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajnë shumën prej 20 /njëzet / Euro, si dhe shumën prej 30 € në emër të kompensimit të viktimave të krimit brenda afatit prej tridhjetë /30/ ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m i

1.Historiku procedurës dhe aktakuza

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e evidentuar si: PP/II.nr.1383-13/19 e datës 23 Shtator 2019, kundër të akuzuarve: Rr.B. nga fshati Komuna Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga nenit 349 par.1 të KPRK-ës, dhe Y.B. nga fshati Komuna Ferizaj për shkak se ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-ës.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar në këtë çështje penale me sipas nenit 245 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 24 Shtator 2020, ku prokurori i shtetit lexoi aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, konform nenit 246 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 323 të KPPK-së, të akuzuarve i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm, në të cilin shqyrtim i akuzuari Rr.B. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa i akuzuari Y.B. ka deklaruar se e ndien veten fajtor dhe e pranon

fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se nuk ka pasur për qëllim të ndihmojë të akuzuarit të parë në kryerjen e veprës penale, por pasi është kthyer nga puna e tij që punon shofer në firmën “..... është ftuar nga ainga i akuzuari i parë që të ndihmojë dhe drunjët të dërgoj deri tek shtëpia e tij sepse të njëjtit i ishte prishur mjete transportues i tij, pasiqë ishin takuar në rrugë dhe i kishte ndihmuar deri tek shtëpia e tij i njëjti ka deklaruar se nuk e ka ditur që këta drunjë i ka pasur me qëllim të shitjes por ka menduar se i ka për nevojat e tij familjare, duke i premtuar gjykatës se nuk do të përsëris vepra të tilla penale, si dhe shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, duke i propozuar gjykatës që të shqiptoj një dënim sa më të ulët.

Pasi që i akuzuari i dytë e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurori i Shtetit Zana Sadiku Sertolli, me rastin e paraqitjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga akuzuarit, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 të KPRK-së si dhe provat materiale dhe faktet e çështjes, prandaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptojë sanksion penal në pajtim me ligjin.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar DBPZH-ës, në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se e mbështetë mendimin e prokurorit të shtetit të pandehurit duke kërkuar nga gjykata që të obligoj në kompensimin e dëmit mirëpo të njëjtën nuk ka mundur ta precizoj.

Pasiqë i akuzuari i parë nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ka ngarkuar aktakuza shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me dëgjimin e dëshmitarëve, prezantimin e provave materiale si dhe fjalën përfundimtare të palëve.

3.Prezantimi i provave

Paraprakisht gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, konkretisht gjatë seancës gjyqësore janë prezantuar provat:

- Raporti i oficerit të policisë me numër 2019-CF-1123 i datës 04 Korrik 2019,

- Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 04 Korrik 2019
- Vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 09 Korrik 2019,
- Kërkesa drejtuar PTH në Ferizaj nga Stacioni Policor në Ferizaj – Njësia e Hetimeve e datës 09 Korrik 2019,
- Urdhëresa për sekuestrim të përkohshëm të mjetit transportues nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal me numër: UGJK.nr.55/19 e datës 11 Korrik 2019,
- Kërkesa me numër : 2019-CF-1123 e datës 05 Gusht 2019, drejtuar Prokurorisë Themelore në Ferizaj nga Stacioni Policor në Ferizaj – Njësia e Hetimeve,
- Certifikata e regjistrimit të automjetit kopje,
- Fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

4. Dëshmia e dëshmitarëve

Gjatë shqyrtimit gjyqësorë në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar Shemsedin Alidema (zyrtar policor në Stacionin Policor me numër të ID #5523) i cili ka deklaruar si në vijim: se data e saktë nuk me kujtohet mirëpo i kujtohet se ishim ne patrullim ne fshatin Nerodime sipas detyrës zyrtare, ku pas njoftimit të marrë nga baza se një person dyshohet qe me kamionetën e tij është duke bartur dru nga pjesa e Jezercit ne drejtim te Ferizajt, ku këtë kamionët të dyshimta e kanë ndaluar në rrugën për në fshatin Balaj, në të cilën kanë qenë 3 persona, ku dy prej tyre i identifikon se gjenden ne sallë dhe i kujtohet se njëri quhet Rrahim kurse tjetri Y.B., ku të njëjtit i kanë legjitimuar mirëpo nuk kanë pasur dokumente identifikimi me vete, shton se nuk i kujtohet nëse kane pasur ndonjë mjet-sharre motorike për prerjen e drunjtëve, gjatë kontrollës se kamionetës kanë vërejtur se ka të ngarkuar drunjë ku për to kanë kërkuar lejen e prerjes, po te njëjtit nuk e kane poseduar, gjithashtu ka shtuar se nuk mund ta di sasinë e drunjtëve as llojin e tyre pasi qe detyra e tyre është qe të ndalojnë diçka te dyshimtë ta dërgojnë në Stacionin Policor ne Ferizaj, ku të njëjtit i kanë dërguar në Stacion Policor mirëpo nuk kam qen i pranishëm gjate marrjes ne pyetje.

Dëshmitari në pyetjet sqaruese të gjyqtares së vetme gjyquese ka deklaruar se gjatë kontrollit të kamionetës personave në fjalë përveç që u kanë munguar dokumentet personale, ju kanë

munguar edhe dokumentet edhe te mjetit transportues –kamionetës, por në vendin e ngjarjes i akuzuari i dytë ka deklaruar se kamioneta është e tij, por nuk i kujtohet se kush ishte duke e vozitur atë duke shtuar se arsyeja e shoqërimit të tyre në Stacionin Policor në Ferizaj ishte sepse të njëjtit nuk posedonin leje përkatëse për bartjen e drunjtëve .

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me dëgjimin e dëshmitarit Njazi Sherifi (zyrtar policor me numër të ID #7459), i cili gjatë dëshmisë së tij ka deklaruar se data e saktë nuk i kujtohet por e din që atë ditë ne Stacionin Policor ne Ferizaj nga ana e patrullës se policisë janë sjellë dy persona te dyshimtë për veprën penale vjedhja e pyllit, duke identifikuar se ata dy persona ishin po të njëjtit persona qe gjenden në sallë, gjithashtu ka shtuar se nuk i kujtohet se me të ka qene ndonjë zyrtar policor tjetër gjatë marrjes ne pyetje ku së pari e kanë marre ne pyetje Rr.B., lidhur me drunjët te cilët gjendeshin ne kamionetën e konfiskuar, i njëjti ka deklaruar se drunjët i ka gjetur te prere ne pyll dhe i ka marr për nevoja personale e jo për shitje, nuk e di me çka i kane prere pasi që në kamionetë nuk ka pasur mjet për prerjen e tyre, ku pas kësaj ka shtuar se kanë konfiskuar drunjët se bashku me kamionetën, nuk e din se me çka i ka bartë masën drunore nga vendi i ngjarjes deri ne vendin ku është ndalu nga policia pasi qe ai vetëm i ka marre ne pyetje ne Stacionin policor ne Ferizaj, mirëpo e din se kur të njëjtit janë ndaluar nga Patrulla e policisë drunjët kane qene te ngarkuara në një kamionët te firmës IVECO, me të cilën edhe janë shoqëruar ne Stacionin Policor ne Ferizaj, dokumente valide se kush është pronar i kamionetës nuk kanë pasur por nga deklarata e Y.B. i njëjti ka pranuar se është pronar i saj, gjithashtu ka shtuar te njëjtit nuk kane pasur lehte përkatëse për prerjen dhe bartjen e drunjtëve.

2.Mbrojtja e të akuzuarit dhe fjala përfundimtare e palëve

I akuzuari në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: nuk e ndien veten fajtor për këtë veprë penale pasi që i njëjti është përgjigjur ne procedurë kundervajtëse dhe është dënuar me dënim ne te holla ne shume prej 250 € për veprën qe e ka kryer me date 04.07.2019 ne fshatin Balaj Komuna Ferizaj ku jam ndaluar nga patrulla e policisë, gjithashtu ka shtuar se data e kryerjes se veprës penale në procedurë kundervajtëse është gabim sepse vepra nuk ka ndodhur me date 24.06.2019 por me datën 04.07.2019, ku me këtë datë ka shkuar ne pyllin publik e quajtur “Reka e madhe” për te mbledhur disa dega te drunjtëve te cilat ishin te hedhura të thyera nga bora por jo te prera, aty ka shkuar me traktorin tim me rimorkio e markës “Bello rus” , nuk e din se sa ka qene sasia e tyre por beson qe kane qene përafërsisht 3m2 ose mbi tri metra katror, te njëjtat i ka ngarkuar ne traktorin tim dhe ka vazhduar rrugën nga fshati

Jezerc ne drejtim te fshatit Nerodime, dhe gjate rrugës te fshatit Jezerc traktorit të tij i është shpërthyer njëra gome dhe nuk kam mundur te vazhdoj rrugën ne atë gjendje dhe është ndalur ne atë rruge dhe e ka thirr ne telefon Y.B., e kam njoftuar se ka probleme me traktor dhe i ka treguar vendin ku gjendet tek lagjja e “Shabanovitëve” në fshatin Jezerc , rreth gjysmë ore pasi ka biseduar ne telefon i akuzuari i dytë me kamionetën e tij të firmës IVECO ka ardhur ne vendin ku gjendej ai dhe kanë vazhduar rrugën për ne shtëpinë e të akuzuarit të parë e cila ndodhet ne fshatin Nerodime e Epërme, mirëpo nuk kanë mundur te arrijnë ne shtëpi sepse gjatë rrugës tek fshati Balaj janë ndaluar nga patrulla e policisë.

Dëshmitari më tutje ka deklaruar se rruga nga vendi ku i ka ngarkuar drunjët ne kamionetën e Y.B.t deri ne vendin ku janë ndaluar policia ka përafërsisht 12 km dhe këtë rrugë e kanë bërë për rreth 40 min., ku pasiqë kanë hyrë ne rrugën e fshatit Balaj janë ndaluar nga policia me anë të sinjalit te tyre të cilët ishin mbrapa kamionetës me veturë zyrtare, pastaj janë ndaluar dhe pasi janë pyetur nga zyrtarët se çfarë kanë në kamionët i njëjti u ka treguar se ka drunjë pasiqë kamioneta ishte e mbuluar me caradë e nuk shihej çfarë ka brenda, nga zyrtarët policor u janë kërkuar dokumentet personale dhe dokumentet e kamionetës , i akuzuari i dytë ua ka dhënë dokumentet e kamionetës dhe pastaj nga zyrtarët policor i është kërkuar që ta hapin çadrën e kamionetës, pastja nga ta janë fotografuar drunjët që gjendeshin brenda, pastaj nga zyrtarët policor janë pyetur se a kanë leje –dokumente për këto drunjte, i njëjti i është përgjigjur se nuk posedon, andaj dhe janë shoqëruar për në Stacionin Policor ne Ferizaj se bashku me patrullën e policisë.

I akuzuari gjatë deklaratës së tij ka shtuar se për marrjen e këtyre drunjëve ne pyllin publik ne vendin e quajtur “Reka e madhe” , ka bërë kërkesë nga Drejtoria per Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, që ti marr drunjët e prerë që ndodhen në pyll, por nga zyrtaret nga Drejtorisë i është thënë se nuk ka nevojë qe te marrë leje ose te bëj kërkesë pasi që me një vendim do të i lejojmë që ti mbledhin drunjët e prerë dhe të dëmtuar po kjo nuk ka ndodhur. Gjithashtu ka deklaruar se edhe më herët ju është lejuar qe ti mbledhim drunjët e thatë të cilët ishin te prerë dhe te dëmtuar dhe për këtë pasi i kemi ngarkuar janë kontrolluar rojet e pyllit dhe te njëjtat janë vulosur.

I akuzuari gjatë mbrojtjes së tij ka njoftuar gjykatën se pasi qe i është dëmtuar traktori i tij e ka telefonuar të akuzuarin e dytë dhe ka kërkuar nga ai qe ti ndihmojë në bartjen e drunjëve për në shtëpinë e tij dhe të rregullojnë traktorin e tij, gjithashtu ka shtuar se i akuzuari i dytë vetëm i ka ndihmuar ti dërgoj drunjët në shtëpi pasiqë i ka treguar se i ka pasur për nevojat e veta

familjare dhe jo me qëllim të shitjes dhe se i njëjti nuk ka qene ne dijeni më herët se ka qenë në pyll dhe ka marre këto drunjë po për rastin është njoftuar pasi qe i është dëmtuar traktori dhe ka ngelur në rrugë ka kërkuar ndihmë nga ai.

Andaj gjatë mbrojtjes së tij dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata ta liroj për këtë vepër penale, edhe pse nuk ka mohuar se ka qenë në pyll mirëpo të njëjtat drunjë nuk i ka prerë por i ka gjetur të prerë dhe për këtë vepër është përgjigjur në procedurë kundërvajtëse.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka mbetur pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, dyshimi i bazuar mire se te akuzuarit e lartë cekur kane kryer veprën penale për te cilën akuzohen , u vërtetua qarte dhe bindshëm nga provat personale si nga dëshmia e dëshmitarëve te cilët ne seancën gjyqësore dëshmuuan se te akuzuarit, patrulla policore i kishin ndaluar, ngase kishin dyshuar se kishin prerë dru ne mënyrë ilegale ku pas kontrollës se kamionetës kishin gjetur mase drusore rreth 4 m3 gjegjesisht te ngarkuar ne kamionetën IVECI ngjyre e verdhe me targa te regjistrimitpronë e të pandehurit Y.B., e cila vërtetohet edhe nga dokumentet gjegjesisht nga certifikata e regjistrimit te automjetit, dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer këto vepra penale u vërtetua edhe nga deklarata e të akuzuarit Rr.B. i cili e pranon se ka qene ne vendin e quajtur “Reka e madhe “ ne rajonin ekonomik pyjor ne Jezerc Komuna Ferizaj, ka qene ne ditën kritike, mirëpo nuk e pranon përgjegjësin penale se ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit me arsyetimin se ditën kritike ka shkuar vetëm për të mbledhur degë të thata apo mbeturina ku të njëjtat i ka ngarkuar në traktorin e tij te markës “ Bello rus”, ndërsa sa i përket deklaratës se pandehurit Y.B. te dhënë me date 04.07.2019, e pranon faktin se ne ditën kritike kishte shkuar ne fshatin Jezerc gjegjesisht ne vendin e quajtur “Te balidët” për të ndihmuar kushëririt te tij tani te akuzuarit Rr.B., i cili e kishte thirrur përmes telefonit pe ti ndihmuar gjegjesisht për ti transportuar drunjët me kamionetën e tij sepse traktori i te akuzuarit Rr.B. ishte prishur gjatë rrugës. Po ashtu nga deklarata e te akuzuarit vërtetohet se drunjët ishin te njoma edhe jo te prera me parë.

Ndërsa nga provat materiale: foto dokumentacioni i cili gjendet ne shkresat e lendes u vërtetua se ne ditën kritike nga i akuzuari Rr.B. ishin prere sasi e konsiderueshme e drunjtëve te njoma, te cilat ishin ngarkuar ne kamionetën e te akuzuarit Y.B., i cili njëjti mjet transportues me urdhëresën e lëshuar nga kjo gjykate me nr.UGJK.55/19 të datës 11.07.2019, është urdhëruar sekuestrimi i përkohshëm ngase është përdorë për kryerjen e veprës penale.

Andaj pas vlerësimit dhe çmuarjes së provave personale dhe ato materiale dhe të ndërlidhura njëra me tjetrën në mënyrë të pa kontestueshme u vërtetuan se në veprimet e kundërligjshme të akuzuarve të përshkruar dy pikat e dispozitivit të kësaj aktakuze, janë përmbushur elementet e veprës penale për të cilën akuzohen, andaj ka kërkuar nga gjykata që të njëjtit të shpallen fajtor për veprën për të cilën akuzohen dhe të shpallen fajtor dhe me rastin e caktimit të dënimit gjykata të merr parasysh si rrethane rënduese dashjen si element subjektiv për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen ndërsa si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin Y.B. të merr pranimin e fajësisë.

5. Vlerësimi i gjykatës lidhur me gjendjen faktike

Gjykata, pas shqyrtimit të aktakuzës së ndryshuar në seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave, po ashtu gjatë seancës gjyqësore por edhe provave tjera që gjinden në shkresat e lëndës, dëgjimit të dëmtuarit, dëshmitarëve dhe mbrojtjes së të akuzuarit ka gjetur se të akuzuarit janë fajtor për veprat penale siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paraprakisht duhet theksuar se në kuptimin objektiv të ekzistimit të veprës penale vjedhja e pyllit, nuk ishte kontestues se ditën kritike janë ndaluar nga policia dhe kanë sekuestruar kamionetën së bashku me drunjtë siç përshkruhet në dispozitiv. Për më tepër nga provat që gjinden në shkresat e lëndës të administruara në këtë shqyrtim gjyqësorë, specifikisht dëgjimi i dy zyrtarëve policor të cilët dëshminë e tyre e kanë dhënë në shqyrtim gjyqësor të cilët kanë përshkruar në detaje se si ka ardhur në përfundim të tillë, tregojnë qartazi se në rastin konkret në kohën dhe vendin siç përshkruhet në dispozitiv, ekziston vepra penale vjedhja e pyllit nga neni 349 ppar.1 të KPRK-ës.

Mirëpo çështja për vlerësim dhe arsyetim ka mbetur aspekti subjektiv i kryerësit të veprës penale, e që në fakt ka qenë teza e prokurorisë se pikërisht i akuzuari, është përgjegjës për kryerjen e veprës penale, si kundër që ka qenë vazhdimisht teza e mbrojtjes se i akuzuari nuk e ka kryer këtë vepër penale për të cilën akuzohet siç përshkruhet në dispozitiv tani të aktgjykimit, duke shtuar se këto drunjë nuk i ka prerë vet por i ka gjetur në pyll të prera dhe të dëmtuara dhe asnjëherë nuk kam dëmtuar pyllin por për nevoja familjare kam marr vetëm ato të cilat ishin të thata dhe nuk i ka prerë.

Nga provat e administruara, është vërtetuar se i akuzuari i parë është përgjegjësi dhe kryerësi kësaj vepre penale, dhe këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoj nga dëgjimi i dëshmitarëve Shemsedin Alidema dhe Nijazi Sherifi dhënë në shqyrtim gjyqësor, të cilët kanë qenë prezentë

në vendin e ngjarjes dhe gjatë marrjes në pyetje në Stacion Policor, ku drunjë të bashku me kamionetën janë sekuestruar.

Gjykata i fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarëve – zyrtarëve policor me që e njëjta është në përputhshmëri edhe me provat tjera materiale si: Raporti i oficerit të policisë me numër 2019-CF-1123 i datës 04 Korrik 2019, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 04 Korrik 2019, Urdhëresa për sekuestrim të përkohshëm të mjetit transportues nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal me numër: UGJK.nr.55/19 e datës 11 Korrik 2019.

Nga raporti i oficerit i përpiluar nga ana e zyrtarëve policor, gjykata vërtetoi se me datë 04 Korrik 2019, në fshatin Balaj është ndaluar kamioneta e ngarkuar me drunjë në mënyrë të parregullt të cilët janë transportuar nga fshati Jezercë, ku personat e dyshuar janë përcjellë në Stacionin Policor në Ferizaj për të dhënë deklaratë ndërsa kamioneta është sekuestruar me urdhëresë për sekuestrim të përkohshëm të mjetit transportues.

Analizuar në aspektin juridik, formësohen gjitha tiparet e veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-ës, pasi që i akuzuari me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetes ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme ka prerë trungje në pyll, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.2003/3 për pyjet e Kosovës, në atë mënyrë që duke përdor sharrë motorike ka prerë drunjë të llojit Ahu, me vëllim të përgjithshëm rreth 4.00 m³, me të cilin veprim i ka shkaktuar dëm palës së dëmtuar dhe për këtë veprë është penalisht përgjegjës dhe është dënuar siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7.Vlerësimi i dënimit të shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69, 70, dhe 71 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese vlerësoi për të akuzuarit, deri më tani të padënuar me aktgjykim të formës së prerë, gjendjen e dobët ekonomike, kryerja e kësaj veprë për nevojat e tyre personale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur pra integritetin fizik të dëmtuarit, mënyrën e kryerjes së veprës penale duke përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme pasurinë e huaj dhe duke dëmtuar pyjet shoqërore të mbrojtura nga shteti,.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarve, andaj duke marrë

parasysh të gjitha të lartëcekurat gjykata ka vlerësuar se edhe me sanksion penal alternativ do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 i KPRK-së, i cili përcakton se *”qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra te lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryerësi të mos kryejë veprë penale”*, kështu që me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv dhe pa ekzekutimin tij do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryesit, që do të shërbej në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

5. Kërkesa pasurore juridike, konfiskimi si dhe shpenzimet procedurale

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht.

Vendimi lidhur me refuzimin e propozimit të prokurorit të shtetit për konfiskimin e mjetit transportues kamionetën e firmës Iveco, ngjyrë e verdhë, me targa të regjistrimit , me numër të shasisë , pronë e të akuzuarit Y.B., është marrë në bazë të nenit 284 par.1 të KPP-ës, meqë nuk është provuar se i akuzuari ka pasur për qëllim që ti ndihmoj të akuzuarit në kryerjen e veprës penale por vetëm i ka ndihmuar që ti bartë drunjët deri tek shtëpia pasiqë të akuzuarit të parë i ka mbetur në rrugë traktori për shkak të defektit të cilin fakt i akuzuari i dytë e ka pranuar në shqyrtimin gjyqësor fillestar, sepse me ndihmë për të kryer veprë penale konsistojnë në ndërmarrjen e veprimeve të tilla me të cilat nuk kryhet vepra penale por vetëm ndihmohet kryerja e saj. Andaj konsiderojmë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara në nenin 115 par. Të KPP-ës, për konfiskimin e mjetit transportues siç është propozuar në dispozitiv të aktakuzës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së.

Në bazë të theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.1012/19 e datës 22 Tetor 2020

Bashkëpunëtor Profesional,
Driton Ahmeti

Gjyqtarja,
Mimoza Shabani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.